

Faqja e parë:

Foto: Lindsay Hassan

Citat : nga dosja fituese

Nënshkrim: nga dosja fituese

Titulli: Projekti Energji për Qëllimet Globale

Lënda : Matematikë, Gjeografi

Mosha: 8-11 vjeçare

Koha: projekt 6 muajsh që kulminon me mësim 60 minutash

Rezultatet e mësimi:

- Të analizohet shfrytëzimi i energjisë dhe letrës në shkollën tuaj, ndoshta edhe të krahasohet me vendet tjera të botës, me të cilët keni lidhje
- Të prezantohen dhe interpretohen të dhënat në tabela dhe grafikë
- Të shfrytëzohen të dhënat si dëshmi në shkrimin e raporteve

Përgatitja e mësimi:

- Ky është një projekt gjashtë muajsh, i cili do t'u nevojitet që të përgatiteni me nxënësit tuaj të realizoni aktivitetet për grumbullim të të dhënave. Qëllimi i grumbullimit të të dhënave është që të merren informacione për shpenzimin e energjisë në shkollë.
- Të caktohen një prezantim përgatitor dhjetë minutash me klasën tuaj, që nxënësit të jenë të vetëdijshëm për projektin dhe të përgatiten për grumbullim të të dhënave gjatë gjashtë muajve.
- Në rastin ideal ky projekt dhe mësimet e marra do të mundësojë përdorimin e linkave ndërkombëtare, të cilat i ka shkolla juaj. Do të ishte e mrekullueshme të ketë disa shkolla nga e gjithë bota, të cilat grumbullojnë të dhëna dhe i shkëmbejnë ato me të tjerët. Nëse shkolla juaj e ka vetëm një lidhje me një shkollë tjetër ose nuk ka asnjë, atëherë do të mund ta bëni si ushtrim në klasë ose shkollë, ku do t'i krahasoni të dhënat e tre muajve të para me të dhënat e tre muajve të fundit.

- Nëse bashkëpunoni me shkolla tjera, atëherë projekti do të mund të drejtohet nga një grup i nxënësve në secilën shkollë, të cilët do të kryejnë detyra në rolin e *Eko ushtarëve* dhe do të mund të komunikojnë mes vete përmes shkëmbimit të monitoruar të postave elektronike. Sidoqoftë kjo nuk është e domosdoshme.
- Nga fillimi i projektit secila shkollë do ta mbikëqyrë përdorimin e energjisë dhe harxhimin e letrës. Kjo detyrë do të bëhet përmes leximit të orëve për matje të shpenzimit të rrymës elektrike njëherë në dy javë. Po ashtu mund të monitorohet përdorimi i gazit – metodat për këtë do të dallojnë varësisht nga shtetet e përfshira. Letra e përdorë do të grumbullohet në qese dhe do të peshohet për çdo javë. Të dhënat do të grumbullohen gjatë 6 muajve.
- Ndërkohë nxënësit do të shkëmbejnë ide për mënyrën e reduktimit të shpenzimeve. Ata do të diskutojnë me shkollat tjera në nivel ndërkombëtar dhe do t'i shkëmbejnë iniciativat përmes postave elektronike, duke dërguar afishe, duke shkruar letra, duke fotografuar praktika të mira dhe të këqija etj. nëse shkolla juaj nuk ka lidhje ndërkombëtare, atëherë ky do të jetë vetëm projekt i klasës.
- Njashtu nxënësit do të mund ta monitorojnë dhe krahasojnë përdorimin e ujit varësisht nga shtetet e përfshira dhe pajisjet në dispozicion.
- Rezultatet e monitorimit do të regjistrohen në tabela. Këto rezultate do të krahasohen imtësisht dhe do të ndahen me të gjitha shkollat e përfshira në projekt.

Qëllimet Globale për Zhvillim të Qëndrueshëm:

- Qëllimi Global 7 - Energjia e pastër
- Qëllimi Global 12 – Konsumimi i përgjegjshëm
- Qëllimi Global 11 – Qytetet dhe bashkësitë e qëndrueshme

Koha	Aktiviteti mësimor
5 minuta	Njoftoni nxënësit me projektin, shpjegoni se ekzistojnë dy aspekte kryesore: (I) grumbullimi i të dhënave dhe analiza e përdorimit të energjisë në shkollë; (ii) mendimi rreth mënyrave për reduktim të përdorimit të energjisë.
10 minuta	Tregojuni atyre sesi t'i grumbullojnë të dhënat e energjisë; (ndoshta duhet paraprakisht të përgatitni një thes mbeturinash dhe një peshore, ose diçka të ngjashme, për ta demonstruar atë); pajtohuni me nxënësit, të cilët do të ndërmarrin aktivitete dhe shpjegoni bashkëpunimin ndërkombëtar (nëse do të bëni këtë).
Njëherë në dy javë gjatë 6 muajve	Në fillim të mësimin, përkujtojuani nxënësve projektin dhe kontrolloni progresin e grumbullimit të të dhënave; prezantoni një ide të mundshme për reduktim të shfrytëzimit të energjisë – p.sh. fokusimi në energji – nxitni nxënësit të japin sugjerime, motivoni nëse kanë vështirës dhe inkurajoni gjatë marrjes së veprimeve.

Pas gjashtë muajve, pasi t'i grumbulloni të dhënat gjashtëmujore ju do të mund ta ndiqni këtë plan mësimor për analizë, prezantim dhe zhvillim të kuptimit të të dhënave:

Koha	Aktiviteti mësimor	Diferencimi dhe alternativat
5 minuta	Prezantoni nxënësve konstatimet e nxjerra nga të dhënat për shkollën tuaj dhe të tjerët (nëse në projekt përfshihet ndokush tjetër). Nëse janë të përfshira më shumë shkolla, atëherë a mund nxënësit ta parashikojnë se cilës shkollë i dedikohen të dhënat? Pyetni nxënësit t'i justifikojnë idetë e tyre.	Nëse ka më shumë se një shkollë të përfshirë, do të mund të ofrohen informacione shtesë për secilën shkollë, siç janë disa informacione themelore, të përgjithshme për motin dhe kohëzgjatjen e orarit të punës së shkollës. Kjo do të ndihmojë në formimin e ideve të nxënësve.
10 minuta	Interpretoni informacionin e prezantuar në tabela. Filloni me rrymë. Paraqitni dy pako të rezultateve, por mos tregoni se nga cila shkollë janë (ose nëse është vetëm shkolla juaj, mos tregoni se nga cila periudhë është - gjashtë muajt e parë, ose gjashtë muajt e dytë). Çka na tregojnë informacionet? Cila shkollë ose në cilën periudhë ka shfrytëzuar më shumë energji elektrike? A ka diçka befasuese për të dhënat? Përsëritni sesionin e ngjashëm të pyetjeve dhe përgjigjeve, duke përdorë dy shembuj të të dhënave të grumbulluara për përdorim të lëndës djegëse. Pastaj përsëritni prezantimin me dy shembuj të të dhënave, të cilat paraqesin harxhimin e letrës. Ndani studentët në grupe. Secili grup ka përgjegjësi për njërin ndër shtetet ose periudhat e përfshira në projekt. Tregojuni nxënësve se nga cili shtet janë dhe jepuni të dhënat. Kërkoni të llogaritet sa energji është përdorë gjatë gjithë kohës së grumbullimit të të dhënave.	Si alternativë, do të mund t'iu jepni nxënësve një pako të të dhënave për secilën variabël të grumbulluar – rryma elektrike, gazi dhe letra – e pastaj pyetni nëse vërejnë ndonjë ngjashmëri ose lidhje ndërmjet tyre. A mund të shpjegojnë pse? Nxënësit do të mund ta llogarisin shumën e përgjithshme të njëres nga të tre pakot e grumbulluara, varësisht nga afinitetet e tyre.
30 minuta	Prezantoni të dhënat e paraqitura në grafikë Mësoni nxënësit sesi t'i prezantojnë të dhënat si grafikë (mund të jenë vija grafike ose shtylla të vizatuara varësisht nga aftësitë e nxënësve). Secili grup duhet të ketë 3 pako të rezultateve të shtetit të tyre ose të	Për nxënësit më të rinj ose me aftësi më të ulët mund të përgatiten grafikë pjesërisht të gatshme, sesa të kompletohet një e tërë nga fillimi. Për nxënësit më të vjetër ose nxënësit me aftësi

	<p>periudhës (për rrymë elektrike, gaz dhe letër të harxhuar). Secili grup i ndan rezultatet e tabelës, ashtu që secili nxënës mund ta prezantojë nga një pako të të dhënave dhe grafikëve. Kjo mund të bëhet në letër në formë të katrorit, ose në kompjuter varësisht nga resurset që ka shkolla në dispozicion.</p>	<p>më të mëdha mund të kompletohen dy grafikë të ndryshëm me të dhënat e njëjta, e pastaj do të krahasohen ato.</p>
20 minuta	<p>Secili grup do t'ia prezantojë grafikët nxënësve tjerë, me qëllim që të mund të bëhen krahasime (duke i mbajtur mend diskutimet paraprake në lidhje me reduktimin e shfrytëzimit të energjisë) dhe duke diskutuar reduktimin e harxhimit të energjisë dhe letrës në shkollën (shkollat e përfshira).</p> <p>Nxënësit duhet t'i shpjegojnë trendet e përgjithshme dhe anomalitë, ose ta theksojnë atë qëndrim në grafikët e tyre. Orvatuni t'iu ndihmoni nxënësve t'i kuptojnë arsyet për sasi të ndryshme të reduktimit të harxhimit të energjisë dhe letrës në pjesë të ndryshme të botës.</p>	<p>Nëse ka në dispozicion teknologji, atëherë keni mundësi të përdoren video konferencë ose Skype (Skajp), që nxënësit t'ua prezantojnë konstatimet e tyre partnerëve të tyre ndërkombëtar, në rastet në të cilat janë përfshirë shkolla tjera.</p>
5 minuta	<p>Kërkoni nga nxënësit ta thonë një fjali, me të cilën do të shpjegojnë një gjë që e kanë mësuar në lidhje me përdorimin e energjisë në shkollën/shkollat e tyre në shtetet e ndryshme në të cilat është realizuar studimi.</p>	<p>Përdorni Librin vjetor global për statistikë të energjisë që të krahasoni më shumë të dhëna të përdora anekënd botës.</p>

Aktivitetet vijuese

- Nxënësit duhet t'i shkruajnë raporte drejtorit të shkollës (dhe/ose të shkollave partnere), ku do të shpjegojnë se çka kanë mësuar dhe në detaje do të japin ide për mënyrën sesi do të mund ta reduktojnë shfrytëzimin e energjisë dhe mbeturinave. Raporti duhet të potencojë se cilat Qëllime Globale kanë të bëjnë me energjinë dhe si veprimet e tyre do të mund ta reduktojnë shfrytëzimin e energjisë në shkollë dhe do të kenë ndikim në nivel lokal dhe global.
- Mund të jetë pjesë e një projekti të vazhdueshëm, në të cilin shkollat vazhdojnë të punojnë së bashku, që t'iu referohen çështjeve të mjedisit jetësor, të cilat më pas mund të ndiqen në shtetin dhe bashkësitë e tyre.
- Për më shumë ide dhe për fëmijët më të rinj ndiqni aventurën me Simonin, Hipopotamin dhe shokët e tij, përderisa ata mësojmë për ndryshimet klimatike në botë, për rolin e dyoksidit të karbonit dhe metanit, si dhe për eko-habitatet e mira të cilat të gjithë mund t'i zhvillojmë. Vizitoni <http://gumroad.com/l/gMOch>. Keni parasysh se ky film dhe këta resurse mund të përdoren falas. Donacioni në fjalë vetëm sugjerohet, por nuk është i detyrueshëm.

